

# RELACION

## PËR

### PROJEKTVENDIMIN

#### “PËR

#### **NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1117, DATË 16.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT 2021-2027 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021-2023”**

### **I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i këtij projektvendimi ka si qëllim ndryshimin e Vendimit nr.1117, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe të Planit të Veprimit 2021-2023” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2024-2025 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027, pas përfundimit të afatit të zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2023.

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave synon të shërbejë si një instrument për të bashkërenduar të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshtetërorë, si dhe partnerët ndërkombëtarë që ndihmojnë e mbështesin vendin në përmirësimin e të gjithë komponentëve të menaxhimit të integruar të kufirit, duke adresuar problematikat e sfidat me mënyrat e mjetet për t’i përballuar ato.

Konsolidimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i të gjithë komponentëve të menaxhimit të integruar të kufirit vijon të mbetet në drejtim të parandalimit dhe goditjes së paligjshmërisë por dhe përmirësimit dhe modernizimit të mëtejshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve si dhe lehtësimin e qarkullimit për shtetasit dhe mallrat. Për realizimin e tyre është e domosdoshme një qasje ndërsektoriale, e koordinuar dhe gjithëpërfshirëse nga të gjithë aktorët, shtetërorë dhe joshtetërorë kombëtarë në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, të cilët duhet të ndërveprojnë në mënyrë të koordinuar dhe efektive.

---

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Plani i Veprimit (PV) 2024-2025 në zbatim të **Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027** është dokument i rëndësishëm politik kombëtar, i cili koordinon sipas fushës së tyre të përgjegjësisë institucionet dhe agjencitë shtetërore që operojnë në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera, organizma ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë. Plani i Veprimit është një shprehje e qartë e vullnetit të Qeverisë Shqiptare për të marrë të gjitha masat e nevojshme të karakterit institucional, ligjor dhe buxhetor për t'iu përgjigjur në mënyrë të koordinuar nevojave dhe objektivave në zbatim të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027.

Bazat e ndëryrjeve dhe veprimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit kanë të bëjnë me përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit, ngritje të kapaciteteve, forcimin e qasjes parandaluese ndaj formave të krimit ndërkufitar, përmirësimin e shkëmbimit të të dhënave ndër-agjenci dhe me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, modernizimin dhe lehtësimin e shërbimeve dhe qarkullimit të shtetasve dhe mallrave.

Ky dokument është konceptuar në zbatim të objektivave të parashikuara në Strategjinë Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe në vazhdim të proceseve të ndërmarra përmes Planit të Veprimit 2021-2023, në përputhje me prioritetet, nevojat, vizionin e qeverisë në qasjen ndaj menaxhimit të integruar të kufirit si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë në interes të zhvillimit të institucioneve dhe përparimit drejt procesit të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Ky projektakt është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme në katërmujorin e II-të të vitit 2024 dhe do të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

Plani bazohet edhe në gjetjet e raportit të vlerësimit të Planit të Veprimit 2021-2023 të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027, në interes të vijueshmërisë së politikave dhe proceseve të ndërmarra dhe reflektimit në mënyrë adekuate të masave të përcaktuara dhe atyre me realizim të ulët, në përputhje me

---

objektivat e strategjisë, të tilla si ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, rritja e veprimtarisë parandaluese dhe zbuluese ndaj paligjshërisë, bazuar dhe në analizat e riskut dhe kërcënimeve, përafrimi i kuadrit ligjor rregullator me atë të BE, përmirësimi i bashkërendimit ndërinstitucional dhe procedurave të përbashkëta të agjencive në kufi, përmirësimi bashkëpunimit me vendet fqinje si dhe me partnerët etj. Gjithashtu, dokumenti adreson gjetjet e rekomandimet e organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në lidhje përmirësimin e komponentëve të menaxhimit të integruar të kufirit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ministria e Brendshme, vlerëson miratimin e Planin të Veprimit 2024-2025 si një instrument të domosdoshëm në zbatim të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027. Në këtë plan përçohet vizioni për sigurimin e një qarkullimi të sigurtë të shtetasve dhe mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror dhe për marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar dhe goditur të gjitha format e krimit ndërkufitar dhe të migrimin të parregullt.

Ky dokument ka si qëllim jetësimin dhe realizimin në kohë dhe më cilësi të tre qëllimeve politike, duke synuar të përcaktojë drejtimit e duhura për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë kufitare. Në këtë kuadër, ky dokument do të fokusohet në përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator me synim përafrimin me *acquis communautaire*, forcimit të kapaciteteve të analizës së riskut, krijimit të kapaciteteve të reja dhe përmirësimin të mëtejshëm të kapaciteteve teknologjike të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, forcimit të mëtejshëm të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve operacionale e profesionale të autoriteteve kompetente dhe agjencive që operojnë në kufi me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar, forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkufitar (me vendet fqinje, vendet e rajonit, vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe agjencitë e tij si dhe me organizatat ndërkombëtare), konsolidimit dhe riorganizimit të strukturave të integruara në kufi, forcimit të kapaciteteve dhe koordinimit ndërinstitucional për kërkimin dhe shpëtimin e shtetasve në situata të rrezikshme në det, vendosjes së një mekanizmi të kontrollit të cilësisë dhe respektimit rigoroz të të drejtëve të njeriut.

Duke miratuar këtë Plan Veprimi, të gjithë aktorët angazhohen të sigurojnë zbatimin e detyrave të përfshira në këtë dokument dhe nën përgjegjësinë e tyre përkatëse, përfshirë sigurimin e burimeve të kërkuara.

---

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Projektvendimi i paraqitur është në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Ai është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, në të cilin ndër të tjera përcaktohet se: “*Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore*”, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”, i ndryshuar, si dhe është hartuar në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara apo konventa, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

PV mbështet synimin strategjik e politik të Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, përmes progresit dhe konsolidimit të institucioneve, rritjes dhe modernizimit të kapaciteteve, përmirësimit të infrastrukturës dhe sistemeve, modernizimit dhe lehtësimit të shërbimeve, forcimit të bashkëpunimit institucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Ky projektvendim nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për fushën e menaxhimit të integruar të kufirit.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Plani i Veprimit 2024 – 2025 është hartuar në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030. Procesi i integritit të vendit në Bashkimin Evropian dhe politikat qeverisëse në fushën e sigurisë, lëvizjes së lirë dhe mallrave, janë orientimet kyçe politike të cilat janë jetësuar në këtë dokument, për sa i takon fushës së menaxhimit të integruar të kufijve.

Ky plan veprimi përçon vizionin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027, duke siguruar që të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë

---

të jenë të angazhuar maksimalisht për sigurimin e një qarkullimi të sigurt të shtetasve dhe mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror dhe duke marrë masat e nevojshme për të parandaluar dhe goditur të gjitha format e krimit ndërkufitar dhe të migrimit të parregullt.

Plani i Veprimit 2024 – 2025 është hartuar në përputhje edhe me misionin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, për koordinimin dhe veprimin e përbashkët të autoriteteve të përfshira në sistemin e menaxhimit të integruar të kufirit, për të minimizuar kërcënimet ndaj sigurisë kufitare, kushtet e brendshme të sigurisë dhe pjesë të sistemit të përgjithshëm të sigurisë të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, dokumenti përcjell vlerat e strategjisë që qëndrojnë në themel të funksionimit të agjencive të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, si profesionalizmi, respekti për të drejtat themelore, bashkëpunimi, transparenca dhe llogaridhënia.

Plani i Veprimit 2024 – 2025 është hartuar gjithashtu në përputhje me Vendimin nr.290, datë 11.4.2020“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (IPSIS)” dhe konceptuar sipas qëllimeve të politikës që mbi të cilat është ndërtuar Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027:

1. Mbrojtja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi i flukseve migratore, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, si dhe parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar.
2. Lehtësimi i qarkullimit legjitim të shtetasve dhe mallrave.
3. Respektimi i plotë e i të drejtave themelore, përfshirë trajtimin e çdo individi me respekt të plotë për dinjitetin dhe mundësimin e qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare të atyre që kanë nevojë.

Hartimi i masave dhe aktiviteteve që përbëjnë këtë plan veprimi, është bërë në interes të plotë të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike përkatës, në bashkëpunim të ngushtë dhe gjithëpërfshirës me institucionet që kanë kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Me qëllim realizmin e objektivave specifike të këtij Plani Veprimi, Agjencitë e Zbatimit të Ligjit, që ngarkohen me detyrime do të ndërhyjnë duke sjellë përmirësime në fushat e mëposhtme:

- Kuadrin ligjor rregullator;
-

- Kuadrin organizativ institucional;
- Kuadrin procedural;
- Infrastrukturë, sisteme, mjete e pajisje;
- Kapacitete njerëzore dhe aftësim profesional.

Në kuadër të Objektivit Specifik: Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe atyre Shengen, në aspektin legjislativ, administrativ dhe institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikqyrjes së kufirit dhe forcimi i bashkëpunimit ndër-agjenci dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohet:

- Miratimi i ligjit "*Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror*" dhe akteve të tij nënligjore, për një përafrim të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar dhe procedural në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit me standardet evropiane. Gjithashtu, me përafrimin e ligjit përmbushet dhe një nga rekomandimet e KE-së sa i përket fushës së menaxhimit kufitar.

Në kuadër të Objektivit Specifik: Përmirësimi i Sistemit për mbikqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim shpëtimit në det, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohen:

- Rishikimi i Planit Kombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit në hapësirën detare duke u përafruar në përputhje me standardet dhe detyrimet e BE-së, me detyra të qarta dhe konkrete për të gjitha institucionet pjesëmarrëse.
- Përmirësimi i kapaciteteve logjistike të Policisë Kufitare dhe Migracionit për mbikëqyrjen e kufirit blu, nëpërmjet instalimit të radarëve për përmirësimin e mbikëqyrjes dhe vëzhgimin e hapësirës detare dhe liqenore, si dhe pajisjes me mjete lundruese.

Në kuadër të Objektivit Specifik: Reduktimi i vulnerabilitetit në kufi duke reaguar në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve të disponueshme, bazuar në analizën e rrezikut të kryer dhe kërcënimit që mund të ndikojë në sigurinë kufitare, në përputhje me modelin e CIRAM të BE-së, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohet:

- Miratimi i Rregullores së Përbashkët për zhvillimin e analizave të përbashkëta të riskut, si bazë për menaxhimin dhe bashkëpunimin e integruar të kufijve ndërmjet Policisë së Shtetit, Autoritetit Doganor dhe
-

Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, si dhe planifikimi dhe ndjekja e trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta

- Përmirësimi të kapaciteteve logjistike për kontrollin kufitar në zbatim të projekteve përkatëse të planifikuara

Në kuadër të Objektivit Specifik: Bashkëpunim i zgjeruar ndërinstytucional në menaxhimin e integruar të kufijve për të përmirësuar trafikun ndërkufitar, përmirësimin e sigurisë kufitare, luftën ndaj krimit ndërkufitar, mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronën e njerëzve, shëndetin e kafshëve, bimësinë dhe ekosistemet përgjatë kufirit shtetëror, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohen:

- Ngritja e Qendrës Kombëtare të Koordinimit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit në kuadër të përmirësimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, për të përmirësuar trafikun ndërkufitar, sigurinë kufitare, ulur paligjshmërinë. E parashikuar në Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe në përmbushje të rekomandimeve të KE-së do të punohet për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Koordinimit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Në interes të këtij objekti, në këtë plan veprimi parashikohet të kryhet një analizë e plotë ligjore, financiare, operacionale, të burimeve njerëzore dhe logjistike, si dhe hartimi i projektaktit për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe ndjekjen e zbatimit të tij deri në fillimin e funksionimit.
- Përmirësimi dhe harmonizimi i procedurave ndërsektoriale të agjencive që veprojnë në kufi në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre ligjore, nëpërmjet miratimit të Rregullores “Për bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit, Administratës Doganore, dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në përputhje me ndryshimet institucionale dhe ligjore, synon rritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive që veprojnë në kufi.

Në kuadër të Objektivit Specifik: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me vendet fqinje, institucionet e BE-së dhe Agjencinë Europianë të Rojes Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX) për çështjet e kufijve, parandalimin e migracionit të paligjshëm, krimit ndërkufitar dhe ripranimin e personave me qëndrim të parregullt, disa nga masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohen:

---

- Zhvillimi i operacioneve të përbashkëta me FRONTEX në zbatim të Marrëveshjes së re Statusore.
- Rritja e mëtejshme dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje në mënyrë të veçantë, rishikimi i marrëveshjeve dhe protokolleve përkatëse me Kosovën me qëllim lehtësimin e qarkullimit dhe procedurave ashtu dhe drejt integritit të sistemeve të kontrollit të dy vendeve.

Në kuadër të Objektivit Specifik: Përmirësimi i infrastrukturës në Pikat e Kalimit Kufitar me qëllim krijimin e kushteve që sigurojnë kalim të lehtësuar dhe të sigurt të shtetasve dhe mallrave, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohen:

- Përmirësimi i infrastrukturës në Pikat e Kalimit Kufitar me qëllim krijimin e kushteve që sigurojnë kalim të lehtësuar dhe të sigurt të shtetasve dhe mallrave.
- Përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve infrastrukturore, modernizimit dhe pajisjes me sisteme dhe mjete sipas projekteve konkrete përkatëse.

Në kuadër të Objektivit specifik: Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe Doganor, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohet:

- Vijimi i punës për nënshkrimin e protokolleve dhe zbatimin e marrëveshjeve për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe Protokollet e zbatimit me vendet fqinje, konkretisht me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Në kuadër të Objektivit Specifik: Alokimi i burimeve të nevojshme njerëzore në Pikat e Kalimit të Kufitar në përputhje me fluksin e qarkullimit ndërkufitar, ndër masat kryesore të parashikuara në këtë Plan Veprimi veçohen:

- Rritja e profesionalizmit dhe integritetit të burimeve njerëzore që veprojnë në agjencitë kufitare, përmes trajnimeve të vazhdueshme teknike e operacionale të planifikuara.
  - Ngritja e kapaciteteve dhe përmirësimet organizative, veçanërisht shtimin dhe plotësimin e burimeve njerëzore në strukturat policore të kufirit;
-

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT**

Plani i Veprimit angazhon një numër të gjerë institucionesh dhe agjencish shtetërore dhe joshtetërore, duke u bazuar në përgjegjësitë, detyrimet dhe kontributin e secilës prej tyre në menaxhimin e integruar të kufirit dhe parandalimin e veprave me karakter ndërkuftar. PV ruan frymën e një bashkëveprimi të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërore dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike të hapur, proaktive dhe gjithëpërfshirëse.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohet në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë, ku rol të rëndësishëm ka Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit si institucion i saj i varësisë por përfshin dhe institucione të tjera shtetërore me përgjegjësi si: Ministria e Financave, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, dhe veçanërisht institucioneve të tyre të varësisë si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Forca detare/Roja Bregdetare, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit etj.

Plani i Veprimit është planifikuar të realizohet në bashkëpunim dhe me aktorë joshtetërorë dhe organizata ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit, veçanërisht me Agjencinë Europiane të Rojes Kufitare dhe Bregdetare/FRONTEX.

Detajimi i këtij Plani Veprimi sjell marrjen e përgjegjësisë shtetërore në planifikimin dhe kostimin e aktiviteteve nga secili institucion, agjenci apo strukturë dhe do të zbatohet nga institucionet shtetërore përmes një qasje të integruar multidisiplinare të agjencive shtetërore.

---

## **VIII. MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT**

Nisma për hartimin e këtij projektakti është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e sigurisë kufitare, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 556, datë 04.10.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, si dhe në Urdhrin nr. 28, datë 22.01.2024 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Planit të Veprimit 2024-2025 të Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027”.

Ky dokument është në përputhje me vizionin e qeverisë, reformave të ndërmarra si dhe detyrimeve në kuadër të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, proceseve rajonale dhe ndërkombëtare.

Hartimi i Planit të Veprimit ka kaluar në një proces gjithëpërfshirës, konsultativ të koordinuar nga Drejtoria e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike në Ministrinë e Brendshme me institucionet përgjegjëse, kontributore dhe përfituese nga ky plan masash, pjesë e Grupit të Punës si dhe aktorë të tjerë. Pjesëmarrësit kanë dhënë propozimet, komentet dhe sugjerimet e tyre qoftë në takimet e zhvilluara, ashtu dhe formë zyrtare shkresore dhe elektronike. Konkretisht janë zhvilluar:

- Takim i parë i Grupit të Punës në datë 22.02. 2024 në Ministrinë e Brendshme;
  - Takimi teknik i grupit tematik ndërinstitucional me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në datë 29.03.2024, mbajtur në Ministrinë e Brendshme;
  - Takim i dytë i Grupit të Punës në datë 24.04.2024 në Ministrinë e Brendshme;
  - Takime të veçanta me anëtarë dhe përfaqësues të institucioneve të përfshira (dy takime në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, me Ministrinë e Mbrojtjes/Qendra Ndërinstitucionale Opreacionale Detare/ Forca Detare, me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave etj.)
-

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen nëpërmjet sistemit e-akte pranë:

- Ministrisë së Financave;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Mbrojtjes;
- Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e Planit të Veprimit 2024 – 2025”, është rreth **3,5 miliardë** Lekë, ose rreth **32 milionë** Euro. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 109 lekë për 1 euro.

Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 2 viteve të zbatimit të Planit të Veprimit 2024 - 2025.

Qëllimi i Politikës				Tipologjia e kostove	Kosto totale	Kosto e planifikuara	Hendeku financiar
		2024-2025	PBA 2024-2026 Buxheti dhe Donoret			2024-2025	
: MBROJTJA E SIGURISË SË BRENDSHME DHE MENAXHIMI I FLUKSEVE MIGRATORE, ME QËLLIM PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT, SI DHE PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT NDËRKUFITAR		1,209,400,280	1,209,400,280			0	
QP2: LEHTËSIMI I QARKULLIMIT LEGAL TË SHTETASVE DHE MALLRAVE	Korente	799,450,000	799,450,000			0	
	Kapitale	825,070,398	825,070,398				

QP3: RESPEKTIMI I PLOTË I TË DREJTAVE THEMELORE, PËRFSHIRË TRAJTIMIN E ÇDO INDIVIDIT ME RESPEKT TË PLOTË PËR DINJITETIN DHE MUNDËSIMIN E QASJES NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË ATYRE QË KANË NEVOJË	Korente	5,783,664	5,783,664	
	Kapitale	0	0	0
TOTALI [Leke]		3,524,629,342	3,524,629,342	0
TOTALI [Euro]		32,336,049	32,336,049	0
1 euro 109Leke				

**Tabela: Kostot indikative të Planit të Veprimit 2024 – 2025**

Shpenzimet e planifikuara për periudhën 2024-2025 në buxhetet e institucioneve përgjegjëse, janë planifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Për periudhën 2024-2025, buxheti i shtetit pritet të financojë **2,7 miliardë** lekë ose 78% të kostove indikative totale të planit për periudhën 2024-2025, ndërsa financimi i huaj është 761 milionë lekë ose 22% të kostove indikative. Hendeku financiar për këtë plan veprimi është në vlerën 0.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI**

**TAULANT BALLA**

